



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 31 Prot

Tiranë, më 17.04 2012

VENDIM Nr. 6 dt. 16.04.2012

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 16.04.2012, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas pikave të rendit të ditës:

VENDOSI

Lidhur me:

Diskutimi i projekteve të restaurimit financiar nga TIKa (Agjencia ndërkombëtare Turke për zhvillim dhe bashkëpunim):

1. **Miratohet me shumicë votash:** Projekti i restaurimit të xhamisë në kalanë e Prezës dhe ngritjen e minaresë sipas origjinalit)
 2. **Miratohet me shumicë votash:** Projekti i restaurimit të xhamisë së Nazireshës, Elbasan, dhe ngritja e minaresë sipas origjinalit).
 3. **Miratohet:** Projekti i restaurimit të xhamisë së Iljaz Bej Mirahorit, Korçë.
 4. **Miratohet:** Projekti i restaurimit të xhamisë së Plumbit, Berat.
 5. **Miratohet:** Projekti i restaurimit të xhamisë në pazarin e Krujës
- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
 - Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
ALDO BUMÇI

SEKRETAR I KKR
AKADEMIK. APOLLON BAÇE